



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 795 / Prot.  
5

Tiranë, më 13/10 /2015

**V E N D I M**

Nr. 42, datë 13/10 /2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, *Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*.

**V Ë R E J S E :**

Në zbatim të Urdhrit nr. 177, datë 09/09/2015 është kryer hetim administrativ pranë subjektit kontrollues *Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*, me objekt:

- Plotësimi i detyrimit për informim, (Neni 18) i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar dhe zbatimi i Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar;
- Plotësimi i detyrimit për njoftim, (Nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar;

Nga hetimi administrativ në vend, në datë 15.09.2015, pranë kontrolluesit, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", grupi i kontrollit konstatoi se, kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet një sistemi video-survejimi CCTV. Në lidhje me detyrimin për informim (neni 18) rezultoi se kontrolluesi ka vendosur tabela informuese në tre hyrjet kryesore të QSUT-së por ato nuk janë sipas modelit standard të miratuar në Udhëzimin nr.3, datë 05/03/2010 të Komisionerit. Në hyrje të godinës së administratës së kontrolluesit e cila është e veçuar nga hyrjet e tjera nuk ka tabela informuese. Në godinat e spitaleve të cilat ndodhen brenda territorit të QSUT-së nuk janë të vendosura tabelat informuese. Në kuadër të garantimit të elementeve të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, kontrolluesi nuk ka hartuar një rregullore të veçantë për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV.

Mungesa e tabelave informuese për kamerat në godinën e administratës dhe në godinat e spitaleve, mungesa e tabelave informuese sipas modelit të parashikuar në Udhëzimin e

mësipërm në hyrjet kryesore të QSUT-së, mungesa e rregullave lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video-surveimit në zbatimin të nenit 27 të ligjit të sipërcituar, ndikojnë në sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video-surveimit dhe në mos informimin e subjekteve të të dhënave mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre të sanksionuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Është e rëndësishme hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë dhe specifike për përpunimin e të dhënave personale, për shkak të numrit të madh të të dhënave personale që grumbullohen nga kontrolluesi, për më tepër të dhëna sensitive që lidhen me gjendjen shëndetësore dhe sensitive në kuptim të nenit 7 të ligjit.

Vlen të theksohet se, pranë kontrolluesit është ushtruar hetim administrativ i mëparshëm në përfundim të të cilit Zyra e Komisionerit ka dalë me Rekomandimin nr 20, datë 11.09.2013. Në hetimin administrativ të mëparshëm janë konstatuar të njëjtat shkelje, të konstatuara në hetimin e datës 15.09.2015. Pra, rezulton që kontrolluesi nuk ka zbatuar rekomandimet e dhëna nga Komisioneri për rikuperimin e shkeljeve dhe është përsëritës në moszbatimin e detyrimeve ligjore.

Në lidhje me plotësimin e detyrimit për njoftim(neni 21,22), nga verifikimet e kryera pranë regjistrin elektronik të KDIMDP-së, u konstatua se ky kontrollues e ka përmbushur detyrimin për njoftim që prej vitit 2010 por, nuk ka përditësuar ndryshimin e gjëndjes së përpunimit të të dhënave.

Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjëndjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji*".

Në çdo rast, Kontrolluesi duhet të njoftojë Zyrën e Komisionerit për ndryshimin e gjëndjes së përpunimit të të dhënave. Shkelja e konstatuar, lidhet me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për t'u informuar se kush përpunon të dhëna personale, cilat janë të dhënat që përpunohen, informimin si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parim bazë i mbrojtjes së të dhënave personale.

Në këto kushte, përpunimi i të dhënave personale pa njoftuar për ndryshim të gjëndjes së njoftimit të përpunimit duke mos e pasqyruar në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese të hapur për publikun, të administruar nga Zyra e Komisionerit, konsiderohet shkelje e rëndë.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", në datë 07/10/2015 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në këtë seancë dëgjimore përfaqësuesit e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" nuk patën kundërshtime në lidhje me konstatimet e grupit të hetimit dhe deklaruan se kanë marrë masa pas kontrollit për rikuperimin e shkeljeve. Rezulton që kontrolluesi është në shkelje të

ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Kontrolluesi ka patur gjithë mundësinë për t'u njohur me ligjin dhe detyrimet e tij, detyrime të cilat i janë bërë të njohura edhe nëpërmjet Rekomandimit nr. 20, datë 11.09.2013 të Komisionerit, të cilin nuk e ka përmbushur.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja "d" dhe "dh" e Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 500 000 lekë.

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Subjekti kontrollues është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me sigurinë e të dhënave personale, detyrimin për njoftim si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit, dhe parime bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, faktin që subjekti kontrollues ka qënë objekt i një hetimi të mëparshëm, si edhe reagimin e kontrolluesit për shkeljet e konstatuara.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Në zbatim të neneve 21, 27, 28, 30, 31, 32/1, 39/1 shkronja "d" dhe "dh", 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

#### **V E N D O S A :**

1. Dënimin e kontrolluesit *Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"* me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit *Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"* me gjobë, në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27,28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit sipas nenit 40 të Ligjit

nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhenave Personale" i ndryshuar dhe nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Ky vendim u shpall sot në, 13 / 10 / 2015

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**  
